



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT SEKTORIAL DHE SIGURISË SË TË DHËNAVE

Nr. 836 Prot.

Tiranë, më 10.06.2025

REKOMANDIM

Nr. 27, datë 10.06.2025

PËR KONTROLLUESIN “DOCTOR’S HOSPITAL”

Në mbështetje të neneve 81, 82, 83 dhe 84 të ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të “*Doctor’s Hospital*”, Tiranë (në vijim, “*Kontrolluesi*”),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 46, datë 05.03.2025 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “*Komisioneri*”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit me objekt:

- *Zbatim i ligjit nr. 124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Laboratori mjekësor “Doctor’s Hospital” Nipt L51621031J, ofron shërbime mjekësore ambulatorë jopublike, kirurgji të përgjithshme, kirurgji plastike, patologji e përgjithshme, gjinekologji, laborator bio-kimik. Shërbim në disa specialitete mjekësore për vizita dhe konsulta mjekësore, diagnostifikim, eko të ndryshme, trajnime ambulatorë, trajnime mikrokirurgjikale si dhe qendër e avancuar endoskopie, fibro-kolonoskopie.

Kontrolluesi në kuadër të veprimtarisë që ushtron, përpunon të dhëna personale për kategoritë “pacientë”; “staf administrativ”; “mjek”; “infirmier”, etj. Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike.

2. Konstatohet se, në dosjet e personelit të larguar ruhen, ndër të tjera, kopje të vërtetimit të gjendjes gjyqësore, kopje të letërnjoftimit, jetëshkrim (CV). Nga analizimi i Rregullores së Brendshme dhe Rregullores për Mbrojtjen e të Dhënave Personale rezulton se, nuk janë parashikuar afate konkrete lidhur me kohën e ruajtjes së të dhënave personale për dokumentacionin që Kontrolluesi administron në funksion të veprimtarisë që ushtron.

Të dhënat e mbledhura për personelin e larguar ruhen nga kontrolluesi pa përcaktuar një afat konkret të ruajtjes së tyre, në kundërshtim me pikën 5, të nenit 6 të Ligjit, si dhe me Udhëzimin nr. 11, datë 08.09.2011 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave të punonjësve në sektorin privat” i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 11”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale të grumbulluara në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar. Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e pikës 5, të nenit 6 të Ligjit.

3. Kontrolluesi disponon një sistem të video-survejit (CCTV) për mbikëqyrjen e ambienteve të jashtme dhe të brendshme të klinikës. Nga verifikimi i kryer në vend konstatohet se, kontrolluesi disponon tabelë informimi për mbikëqyrjen e ambienteve me sistemin CCTV, por nuk është sipas modelit standard të miratuar nga Komisioneri, në kundërshtim me parashikimin e nenit 13 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video-survejit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-survejit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit. Sipas Udhëzimit nr. 3, subjektet e të dhënave duhet të informohen qartësisht që një sistem video-survejimi është në veprim, duke vendosur në ambientet e survejuara modelin standard të tabelës informuese për mbikëqyrjen me sistemin e survejit, të miratuar nga Komisioneri.

4. Konstatohet se, kontrolluesi nuk ka të publikuar rubrikën “Politikat e Privatësisë” në faqen web “<https://doctorshospital.al/>”. Subjektet e të dhënave personale nuk informohen mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin

që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me parashikimet e nenit 13 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes zyrtare të internetit, ka detyrim që të publikojë “*Politikën e Privatësisë*” dhe të informojë qartësisht subjektet e të dhënave, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash me kontrolluesin realizohet nëpërmjet faqes së internetit.

5. Doctor's Hospital, ka lidhur “*Kontratë shërbimi mirëmbajtje e sistemit kompjuterik*”, më datë 05.01.2024 me objekt shërbim mirëmbajtje database, në të cilën Doctor's Hospital është në cilësinë e autoritetit kontraktor dhe “ ” p.f (Eniac Services) në cilësinë e kontraktuesit. Gjithashtu, kontrolluesi ka lidhur kontratë bashkëpunimi me Shoqërinë “*Intermedica Center*” sh.p.k nr. 01 prot., datë 03.01.2024 për kryerjen e ekzaminimeve laboratorike klinike, biokimike, hormonale, bakteriologjike, citologjike, parazitologjike etj., dhe kontratë bashkëpunimi me “*Hygeia Hospital Tirana*” sh.a datë 10.11.2017, nëpërmjet së cilës, ofron klientëve shërbime shëndetësore të specializuara, në ambientet e spitalit Hygeia.

Nga analizimi i përmbajtjes së kontratave të mësipërme konstatohet se, nuk specifikohen masat konkrete teknike-organizative të detyrueshme për t'u zbatuar nga ana e përpunuesit, me qëllim garantimin e sigurisë dhe përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale dhe të dhënave sensitive, si dhe nuk janë reflektuar detyrimet sipas parashikimeve në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19 të Komisionerit, datë 03.08.2012 “*Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi*” i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 19*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave Kontrolluesi duhet të miratojë një akt/kontratë, që palët duhet të përdorin në rast të këtij delegimi, me anë të së cilës të garantojë përcaktimin e rregullave në marrëdhënien e tij me përpunuesin, me qëllim që delegimi i përpunimit të këtyre të dhënave të përpunuesit të jetë në përputhje me nenin 26 të Ligjit dhe me Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit. Në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe/ose shërbimit, Kontrolluesi duhet të sigurohet që përpunuesi të garantojë përpunim të ligjshëm dhe të sigurt të të dhënave.

6. Kontrolluesi disponon rregullore “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, por nga shqyrtimi i përmbajtjes së saj rezulton se, rregullorja i referohet modelit “tip” të publikuar në faqen zyrtare të Zyrës së Komisionerit.

Gjithashtu, në rregullore nuk reflektohen detyrimet ligjore, proceset përpunuese, procedurat, masat teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të

dhënave personale, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., në kundërshtim me parashikimet e nenit 28 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i rregullores “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*” dhe përshtatja e dispozitave të saj, në mënyrë të tillë që, në të të parashikohen në mënyrë të detajuar rregulla dhe procedura mbi kategoritë e të dhënave personale që përpunohen në veçanti të dhënat sensitive, mënyrën e përpunimit, masat e sigurisë dhe konfidencialitetit, afatet e ruajtjes, të drejtat e subjekteve të të dhënave, si dhe përcaktimin e niveleve të aksesit, me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave, në përputhje me proceset përpunuese të Kontrolluesit dhe në zbatim të nenit 28 të Ligjit.

7. Konstatohet se, të dhënat sensitive të administruara nëpërmjet kartelave fizike dhe çdo dokumentacioni tjetër shëndetësor, ruhen në ambiente jo të përshtatshme, duke mos marrë, midis të tjerash, masa organizative dhe fizike, si një kategori e veçantë, të cilës duhet t’i sigurohet mbrojtje e dyfishtë dhe vëmendje e shtuar për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e tyre, në përputhje me nenin 28 të Ligjit, Udhëzimi N nr. 49, datë 02.03.2020 “*Për mbrojtjen e të dhënave shëndetësore*” (në vijim, “Udhëzimi nr. 49”) dhe Vendimin nr. 6 “*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*” të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se hartimi i një “*Rregulloreje specifike për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, në të cilën të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj., konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 28 të ligjit dhe Udhëzimit nr. 49, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

8. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Grupi i kontrollit konstaton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*”, (në vijim, “Udhëzimi nr.47”) për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veçantë të veprimtarisë që Kontrolluesi ushtron.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, sipas parashikimeve të Kreut IV të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve

që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Ky është një detyrim i vazhdueshëm i Kontrolluesit që personeli i subjektit përpunues të të dhënave personale të trajnohet rregullisht për mbrojtjen e të dhënave personale.

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron (përpunon të dhëna sensitive), e cila kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave, Kontrolluesi, është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

SMSI për mbrojtjen e të dhënave personale duhet të bazohet në standardin ISO/IEC 27001, siç parashikohet në nenin 5 të Udhëzimit nr. 48, datë 14.09.2018, të Komisionerit *“Për certifikimin e sistemeve të sigurisë së informacionit, të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre”*, si dhe është një sistem i certifikueshëm, për qëllime përputhshmërie me standardin e sipërpërmendur, vetëm me organizma të akredituar dhe autorizuar sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është vendosur në dispozicion Kontrolluesit nëpërmjet rrugës postare.

Në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesi është ftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore më datë 29.04.2025, organizuar nga Zyra e Komisionerit dhe ka deklaruar angazhimin për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara gjatë hetimit administrativ të ushtruar.

Në përfundim, Zyra e Komisionerit vlerëson bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit, gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar shkeljet e konstatuara. Plotësimi i këtyre detyrimeve nga ana e Kontrolluesit është mjaft i rëndësishëm pasi garanton përpunimin e ligjshëm, sigurinë e të dhënave personale dhe shmang mundësinë e përhapjes së tyre në mënyrë të paligjshme.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6, 13, 26 , 28, 81, 82, 83 dhe 84 të Ligjit

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të ketë në vëmendje të vazhdueshme përpunimin e të dhënave personale dhe sensitive në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 6 të Ligjit dhe të

Udhëzimit nr. 49, si dhe të marrë masa për adresimin e konstatimeve të Komisionerit sa i takon përcaktimit të afateve për ruajtjen e të dhënave personale;

2. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 13 të Ligjit, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale;
3. Kontrolluesi, të marrë masa për vendosjen e tabelave informuese në ambientet e survejuara përmes sistemit CCTV, sipas modelit standard të miratuar në Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 13 të Ligjit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për të rishikuar marrëveshjet e bashkëpunimit me përpunuesit, duke specifikuar detyrimet midis palëve, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 26 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19;
5. Kontrolluesi, në zbatim të nenit 28 të Ligjit, të përfshijë në Rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*”, masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, për çdo kategori të dhënash dhe për çdo proces përpunimi, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj.;
6. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale si dhe krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMIS) për mbrojtjen e të dhënave personale;
7. Kontrolluesi, për shkak të natyrës së veçantë të aktivitetit që ushtron, duhet të marrë masat e nevojshme për të vlerësuar mbi certifikimin e sistemeve të menaxhimit të sigurisë së informacionit, të të dhënave personale dhe mbrojtjes së tyre, sipas parashikimeve të Udhëzimit nr. 48;
8. Në zbatim të nenit 84 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:
 - (i) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 2 më sipër;
 - (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 1 dhe 3 më sipër;
 - (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikat 4 dhe 5 më sipër;
 - (iv) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimin e përcaktuar në pikën 6 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Komisionerin për masat e marra;

10. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri, bazuar në germën “a”, pika 2, e nenit 83 të Ligjit, paralajmëron kontrolluesit ose përpunuesit se veprimet e përpunimit mund të rezultojnë në mosplotësim të dispozitave ligjore dhe u jep atyre rekomandime lidhur me përputhshmërinë me ligjin. Në rast shkeljesh serioze ose të qëllimshme të dispozitave ligjore, Komisioneri vepron sipas neneve 92, 93 dhe 94 të Ligjit, për vendosjen e sanksioneve administrative në përputhje me nenet përkatëse, si dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative, në mënyrë të tillë që këto masa të jenë efektive, proporcionale dhe me karakter parandalues.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 10.06.2025.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi